

# **NDËRGJEGJËSIMI DHE AKTIVIZIMI QYTETAR PËR RITJEN E TRANSPARENCËS NË BASHKINË LEZHË**

## **STUDIM**

**2023**



Ky libër është mundësuar me mbështetjen financiare të AMSHC-së.  
Përmbajtja e tij është përgjegjësie autorit, opinioni i shprehur në të  
nuk është domosdoshmërisht opinioni i AMSHC-së.

## **PËRMBAJTJA**

### **1. PARATHËNIE**

### **2. SFIDAT PËR TRANSPARENCË**

2.1. Ndërgjegjësimi dhe organizimi i qytetarëve

2.2. Monitorimi i punëve publike

2.3. Avokatura e politikave publike

### **3. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL**

3.1 Kuadri ligjor për të drejtën e informimit

3.2 Kuadri institucional për të drejtën e informimit

### **4. AKSESI NË INFORMACION**

### **5. E DREJTA PËR INFORMIM**

### **6. MONITORIMI DHE PËRGJEGJËSIA QYTETARE**

### **7. METODOLOGJIA E STUDIMIT**

### **8. FAZAT E STUDIMIT**

8.1. Krijimi i hartës së kontakteve

8.2. Anketimi

8.3. Grumbullimi i të dhënave

8.4. Hartimi i raportit studimor

### **9. TË DHËNA PËR BASHKINË LEZHË**

### **10. FUSHAT E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS**

10.1. Nivelet e transparencës

10.2. Nivelet e vlerësimit

### **11. PIKAT E FORTA E TË DOBËTA**

### **12. REKOMANDIME**



## 1. PARATHËNIE

Shqipëria ka një kuadër ligjor të kompletuar lidhur me transparencën e institucioneve publike. Çdo institucion publik ka të deklaruar në faqen e tij zyrtare një rubrikë të veçantë që quhet Programi i Transparencës. Kështu që mund të thuhet pa hezitim se e drejta ligjore për tu informuar është e garantuar në Shqipëri. Megjithatë drejtuesit në qeverisjen vendore shpesh gjejnë shtigje për tu shmangur nga detyrimi ligjor për trasparencë të institucioneve që drejtojnë përpara qytetarëve. Si pasojë veprimtaria e tyre çon në vendimmarrje të pa konsultuara me qytetarët, bazuar në metoda arbitrare që sjellin abuzim dhe korrupsion.

Roli i organizatave të shoqërisë civile për rritjen e ndërgjegjësimit qytetar me qëllim nxitjen e aktivizimit për të kërkuar transparencë të plotë për të zgjedhurit e tyre në qeverisjen vendore është i nevojshëm për tu dhënë përgjigje disa pyetjeve: A ka në të vërtetë trasparencë në institucionet publike vendore? Cili është niveli i transparencës reale në veprimtarinë e qeverisjes vendore në Shqipëri? Çfarë duhet bërë më tepër në mënyrë që institucionet publike vendore të funksionojnë në trasparencë të plotë? Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhet të shqetësojë çdo taksapagues, në mënyrë që qeverisja të jetë sa më e pastër dhe efektive.

Aktivizimi qytetar në rritje ka detyruar institucionet publike të qeverisjes vendore të marrin në konsideratë përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe krijimin e hapësirave për transparencë. Gjithësesi, presioni qytetar nuk është shoqëruar gjithnjë me iniciativa konkrete konsultimi për të kërkuar transparencë si nga institucioni i Kryetarit të Bashkisë ashtu edhe për vendimet e Këshillit Bashkiak.

Në bashkëpunim me AMSHC-në, Qendra IBRI ka përgatitur ka realizuar një anketim me qytetarë të bashkisë së Lezhës, për të tërhequr opinionin e tyre lidhur me transparencën në këtë bashki. Po ashtu, është monitoruar në detaje Programi i Transparencës në faqen zyrtare të bashkisë së Lezhës dhe, nëpërmjet vlerësimit të realizimit të të gjithë treguesve, është vlerësuar

niveli i transparencës së vetëqeverisjes vendore në këtë bashki. Rezultatet e këtyre aktiviteteve janë përmbledhur në një material studimor me qëllim përcaktimin e situatës reale në fushën e qeverisjes së hapur, e cila apërfshin transparencën dhe komunikimin efektiv me qytetarët. Ky dokument i adresohet vendim-marrësve të njësive vendore dhe strukturave shtetërore që merren me problematikat e pushtetit vendor. Gjithashtu, mund të jetë i dobishëm për përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare. Është e provuar tashmë se sa më shumë të zbresim në hierarkinë e strukturave qeverisëse, aq më shumë rritet qeverisja e hapur, duke qenë se strukturat vendore janë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët. Rasti i Bashkisë Lezhë e tregon këtë.



## **2. SFIDAT PËR TRANSPARENCË**

Korniza ligjore për informimin e publikut është nga më të përparuarat në Europë. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, detyron çdo institucion shtetëror t’i përgjigjet çdo kërkesë qytetare dhe të japë informacion publik për veprimtarinë e pa klasifikuar. Megjithatë shpesh vihen re raste kur zyrtarët nuk respektojnë ligjin, shmangen ndaj kërkesave qytetare për transparencë, ose i interpretojnë ato sipas dëshirës së tyre. Menaxhimi i burimeve të informacionit publik për qëllime jo ligjore, ose korruptive, vazhdon të mbetet i fuqishëm.

Nismat qytetare që promovojnë demokratizimin e jetës publike janë përballur me autoritarizmin e qeverive vendore, që përdorin mekanizma pengues për të mbajtur mbrapa nismat e qytetarëve që promovojnë transparencën.

Në rrugën e sigurimit të transparencës ekzistojnë disa faktorë frenues si, indiferenca konformizmi, apo frika. Për krijimin e praktikave të mira në drejtim të ndërtimit të transparencës në qeverisjen vendore, janë të nevojshëm disa hapa si:

- Ndërgjegjësimi dhe organizimi i qytetarëve.
- Monitorimi i punëve publike.
- Advokimi qytetar për zbatimin e politikave publike.

### **2.1. Ndërgjegjësimi dhe organizimi i qytetarëve**

Ligji për qeverisjen vendore përcakton që mbledhjet e këshillit bashkiak të jenë të hapura. Por në realitet qytetarët marrin pjesë vetëm kur kanë ndonjë problematikë personale. Qytetarët duhet të bëjnë presion ndaj këshillit bashkiak për të mbajtur të paktën një herë në tre muaj një seancë publike të hapuhur. Në funksion të zgjerimit të demokracisë, kjo gjë mund të futet në ligj, në mënyrë që pjesëmarrja të jetë konkrete. Roli që luajnë grupet e qytetarëve

dhe organizatat shoqërore përkundër tendencave të pushtetarëve vendor që, në shumë raste, janë të prirur drejt autoritarizmit dhe përdorimit arbitrar të burimeve është i madh. Institucionalizimi i procesit të transparencës në jetën e përditshme politike kërkon në radhë të parë ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe më tej organizimin e tyre. Këto dy komponentë duhet të funksionojnë vazhdimisht për të mbajtur nën presion qeverisjen vendore, nëpërmjet formimit të strukturave qytetare të organizuara për të kontribuar në zgjidhjen e problemeve të përditshme.

Drejtimesit organizatave qytetare u drejtohen banorëve për t'u përfshirë në një dialog në lidhje me një problem, me një projekt shoqëror, ose një veprim qeveritar, që është zgjidhur në një mënyrë të parregullt. Ky angazhim bën të nevojshëm kërkimin e një informacioni më specifik publik. Grupet qytetare të organizuara, më pas marrin përsipër të japin informacione dhe adresojnë kritika ose propozime, në mënyrë që të riorientojnë zhvillimin e një projekti shoqëror, të korrigjojnë rezultatet, ose të menaxhojnë një projekt të ri.

Duke u bazuar në ligjet për transparencën publike, qytetarët kërkojnë dhe analizojnë informacionet zyrtare dhe pastaj i krahasojnë ato me realitetin. Në rastin e marrjes së informacionit për çështje të veçanta, qytetarët krijojnë struktura të posaçme për mbikëqyrje (kjo zakonisht në këshillin bashkiak). Grupi i ekspertëve të organizatave të shoqërisë civile trajnon përfaqësuesit e qytetarëve, në procedurat për paraqitjen e kërkesave për informim publik, interpretimin dhe përdorimin e tyre për të monitoruar investimet dhe shërbimet publike, ose zbatimin e akteve ligjore dhe programeve qeveritare.

## **2.2. Monitorimi i punëve publike**

Monitorimi qytetar bën të mundur korrigjimin e veprimeve të qeverisë. Bazuar në informacionin e grumbulluar, grupi qytetar organizon monitorimin e punëve të bashkisë, investimeve dhe shërbimeve. Me mbështetjen e komunitetit, struktura qytetare (në formë bordi) kontakton personin/pushtetarin përgjegjës për projektin publik, për të diskutuar detajet në informacionin e marrë. Struktura monitoron projektin publik duke identifikuar:

- Subjektet që do të monitorohen (kush ka nevojë për monitorim)
- Objektivat e monitorimit (çfarë ka nevojë për monitorim)



- Metodologjinë e monitorimit (si do të monitorohet)
- Shpeshtësinë e monitorimit (afatet)
- Llojin e përgjegjesisë dhe strukturën përgjegjëse
- Propozimet për përmirësim që do t'u vihen autoriteteve.

Pas këtij procesi, bordi është në gjendje të kërkojë përdorimin e duhur të burimeve publike nga organi i qeverisjes vendore. Kjo është faza kur qytetarët afrohen drejt zgjidhjes së problemit fillestar.

### 2.3. Avokatura e politikave publike

Advokimi i politikave publike ka për qëllim organizimin e veprimeve qytetare në mënyrë që ti detyrojnë qeveritarët lokalë të marrin parasysh kërkesa qytetare në zbatimin e programeve publike. Pas arritjes së rezultateve fillestare në favor të tyre nga ky proces, qytetarët arrijnë në përfundimin se politikat, ose programet publike, si dhe proceset e vendimmarrjes dhe zbatimit të tyre, duhet të ndryshojnë. Ata bëjnë propozimet përkatëse për vendimmarrjen në këshillin e bashkisë, ose struktura të tjera qeverisëse në qendër dhe në bazë. Marrja parasysh e propozimeve qytetare varet shumë nga niveli i organizimit qytetar, një gjë e vështirë kjo për tu arritur, për arsye të indiferencës së strukturave qytetare në proceset pjesëmarrëse.



## **3. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL**

### **3.1 Kuadri ligjor për të drejtën e informimit**

#### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e informimit si dhe të drejtën e kujtdo për të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore/personave në funksione shtetërore. Ndërsa sanksionimin e parimit për një qeverisje të hapur dhe transparente, e gjejmë në një nen të veçantë, citoj: “Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive”.

#### **Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative**

Parimi i transparencës është sanksionuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe i detyron institucionet publike të jenë transparentë dhe të bashkëpunojnë me qytetarët dhe grupet e interesit. Po ashtu në Kodin e Procedurave Administrative sanksionohet parimi i informimit, ku thuhet se: “Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit”. Kodi i Procedurave Administrative përshkruan detyrimet e administratës për informimin e qytetarëve, duke mbështetur parimin e një administrate të hapur dhe transparente.

#### **Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”**

Ligji që garanton të drejtën e informimit në lidhje me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritet publike është Ligji Nr. 119/2014, “Për

të drejtën e informimit”. Ky ligj synon garantimin e njohjes së publikut me informacion në kuadër të ushtrimit në praktikë të të drejtave dhe lirive të individit si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë. Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim nxitjen e integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Ligji parashikon informimin me kërkesë dhe informimin pa kërkesë. Informimi me kërkesë është e drejta e qytetarëve për të kërkuar informacion pa shpjeguar motivet e kërkesës dhe detyrimi i institucioneve publike për të përmbushur këtë të drejtë duke respektuar kufizimet e të drejtës së informimit. Informimi pa kërkesë është detyrimi i institucioneve publike për të publikuar informacionet publike që prodhohen dhe disponohen prej tyre. Informimi pa kërkesë realizohet nëpërmjet Programit të Transparencës, që është tërësia e informacionit dhe format e bërjes publike të tij nga institucioni publik. Në nenin 7 të Ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, janë parashikuar të gjitha kategoritë e informacionit që duhet të përmbajë Programi i Transparencës.

### **Ligji Nr. 139 /2014 “Për vetëqeverisjen vendore”**

Ligjet që rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, si dhe përcakton funksionet, kompetencat dhe të drejtat e tyre është Ligji Nr. 139 /2014 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. E drejta për informim e qytetarëve në nivel lokal përcaktohet edhe në këtë ligj duke siguruar transparencën në punën e organeve të qeverisjes vendore dhe mundësinë që publiku të marrë pjesë aktive në qeverisje. Ligji i kushton rëndësi dhe hapësirë të veçantë garantimit të së drejtës së informimit të qytetarëve dhe pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje. E drejta e publikut për informim dhe parimi i transparencës të sanksionuara në këtë ligj përfshijnë detyrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre, të publikojnë aktet e tyre në faqen zyrtare të internetit dhe t’i afishojnë. Po ashtu ligji përcakton që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatoren e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë qytetarët.

### **Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”**

Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ligji përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga institucionet publike.

### **Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**

Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” parashikon rregullimin e procedurave të financimit të njësisë të vetëqeverisjes vendore, transfertat nga qeverisja qendrore tek ajo vendore, si dhe përcaktimin e rregullave për politikën, instrumentet dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në nivel vendor. Ky ligj detyron transparencë për çështje që lidhen me transfertat nga qeverisja qendrore tek ajo vendore, politikën e menaxhimit të fondeve publike, marrëveshjet që lidhin njësitë e qeverisjes vendore dhe shitjen/dhënien me qira të pronave dhe asetëve të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky ligj parashikon, gjithashtu, detyrimin e njësisë të qeverisjes vendore për të publikuar dokumente me rëndësi, të tilla si vendimet për detyrimet fiskale vendore, bazën e taksave dhe tarifave, gjobat, asetet dhe pronat e ofruara për shitje ose dhënie me qira, dhe buxhetin vjetor.

### **Ligji Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”**

Ky ligj rregullon marrëdhënien ndërmjet shtetit dhe nëpunësve civil dhe e ka transparencën si një parim kryesor të administrimit të shërbimit civil. Gjithashtu, ky ligj parashikon detyrimin e çdo nëpunësi civil këtu përfshihet edhe administrata vendore për transparencë dhe informim ndaj publikut, citoj: “Nëpunësi civil ka detyrimin të ushtrojë detyrën e tij në shërbimin civil me transparencë dhe të sigurojë për publikun e gjerë dhe palët çdo informacion të nevojshëm, me përjashtim të rasteve, kur ai është klasifikuar sekret shtetëror sipas ligjit”.

### **3.2 Kuadri institucional për të drejtën e informimit**

Aktorët që përfshihen në procesin e monitorimit të transparencës në nivel vendor janë:

#### **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Është institucioni public që ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas Ligjit Nr. 139/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftim dhe konsultim publik”. Komisioneri sipas rastit u propozon bashkive përgjegjëse rekomandime apo dhe masa administrative përkatëse.

#### **Këshilli Bashkiak**

Këshilli Bashkiak është organi përfaqësues i bashkisë i cili mbikëqyr informimin e publikut nga administrata e bashkisë, është përgjegjës për zhvillimin e seancave të këshillimit me publikun dhe konsultimeve, si dhe garanton pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Këshilli Bashkiak është organi që miraton Programin e Transparencës së bashkisë dhe informacionin përkatës sipas fushave të tij dhe si i tillë mund të ndëtojë mekanizma për monitorimin e zbatimit të tij nga administrata e bashkisë.

#### **Kryetari i Bashkisë**

Kryetari i Bashkisë, është organi ekzekutiv i bashkisë dhe titullari i institucionit, që mbikëqyr procesin e zbatimit të Programit të Transparencës nga ana e administratës së bashkisë dhe njësive administrative.

#### **Aktorët jopublikë**

Në aktorët jopublikë përfshihen organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët dhe grupe të ndryshme interesi, të cilët kanë një rol të rëndësishëm si mbikëqyrës të jashtëm të zbatimit të Programit të Transparencës. Këta aktorë, nëpërmjet veprimtarisë së tyre monitoruese, i nxisin njësitë e vetëqeverisjes vendore të përmirësojnë transparencën. Roli i aktorëve jopublikë është veçanërisht i rëndësishëm gjatë periudhave të emergjencave (si tërmet dhe pandemia), duke i shërbyer jo vetëm monitorimit por edhe kërkesës për përgjegjshmëri më të lartë të vendimmarrësve vendor, fushata për mbledhjen e fondeve, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin për problematika të ndryshme nëpërmjet denoncimit publik



## 4. AKSESI NË INFORMACION

Njësitë e vetëqeverisjes vendore si ofrues të shërbimeve publike në nivel vendor, kanë një rol kryesor në informimin publik dhe mundësimin e vendimmarrjes vendore me pjesëmarrje. Aksesit në informacionin publik i fuqizon qytetarët për të kërkuar të drejtat e tyre, për të ndërmarrë veprime apo për të bërë zgjedhje të informuara. Nga ana tjetër, aksesit në informacion krijon kushtet e përshtatshme për qytetarët dhe shoqërinë civile që të jenë më të ndërgjegjshëm për rolin mbikëqyrës që kanë ndaj qeverisjes, duke nxitur kështu pjesëmarrjen në vendimmarrje, duke krijuar kushtet për një qeverisje të hapur dhe duke garantuar më shumë transparencë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, si autoritete publike, kanë detyrim për të garantuar të drejtën për informim për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre. Rritja e besimit të qytetarëve ndaj qeverisjes krijon mundësi për një komunikim të hapur ndërmjet qeverisjes vendore dhe qytetarëve. Për ta realizuar këtë komunikim është e nevojshme krijimi i zyrave të informimit qytetar, publikimi i përditësuar i informacionit në PT si dhe përdorimi i rrjeteve sociale për informuar qytetarët për çështje të ndryshme.



## 5. E DREJTA PËR INFORMIM

Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” u garanton qytetarëve akses te dokumentet zyrtare dhe parashikon që institucionet shtetërore të vënë në dispozicion informacionin pa kërkuar motivet. Dhënia e informacionit pa kërkesë realizohet përmes hartimit dhe miratimit të Programit të Transparencës, të cilin duhet ta publikojë çdo institucion. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar një model të Programit të Transparencës (PT) për qeverisjen vendore dhe bashkitë kanë detyrimin ligjor ta zbatojnë atë për informimin e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë në lidhje me veprimtarinë e tyre. Organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e ndryshme të interesit, kanë një rol të rëndësishëm si mbikëqyrës dhe monitorues të zbatimit të Programit të Transparencës. Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” tregon se informacioni publik nuk është pronë e autoritetet qeveritare, por e qytetarëve. Rrjedhojë e këtij ligji janë formate të standardizuara, udhëzime dhe mjete të tjera orientuese për qytetarët për të gjetur më mënyrat më të thjeshta dhe efikase për tu informuar. Synimi i këtij studimi është ndërgjegjësimi i qytetarëve për të kërkuar vazhdimisht informacion publik si mjet presioni ndaj qeverisë vendore, në funksion të përmirësimit të jetesës së tyre dhe zbatimi i kuadrit ligjor nga strukturat qeveritare në përgjigje të interesit qytetar. Informacioni përfshin disa nga problematikat më kryesore që lidhen me jetën e qytetarëve, si hartimi dhe miratimi i buxhetit të bashkisë, shpenzimet për disa nga shërbimet bazë si arsimit, shëndetësia, mbështetje sociale, punët publike, etj. Por, megjithatë, sigurimi i informacionit është i pamjaftueshëm, pa gjetur shkakun problemeve dhe rrugët zgjidhjes së tyre.



## 6. MONITORIMI DHE PËRGJEGJËSIA QYTETARE

Gjatë realizimit të një investimi të qeverisjes vendore për komunitetin, qytetarët duhet të njihen me buxhetin e akorduar, afatin e zhvillimit, burimet e përdorura, si dhe projektuesin dhe zbatuesin e investimit. Procesi i të kuptuarit të asaj që ndodh quhet monitorim dhe mbikëqyrje. Ky proces përfshin vëzhgimin, analizën, krahasimin dhe verifikimin nëse informacioni publik i dhënë nga qeveria vendore është në përputhje me atë që ndodh në terren. Angazhimi qytetar bën të mundur kontrollin e informacionit zyrtar në raport me realitetin, krahasimin e tij me rastet e tjera, nxjerrjen e konkluzioneve dhe bërjen e propozimeve për korrigjimin ose zgjidhjen e problemit që ka nxitur kërkimin e informacionit.

Përgjegjësia qytetare që synon përmirësimin e programeve publike në mënyrë që ata të mund të veprojnë me efektivitet, në kohë dhe cilësi, në përputhje me ligjet në fuqi. Në praktikën e mira të qeverisjes vendore, transparencën konsiderohet si baza e qeverisjes së mirë dhe komuniteteve të forta. Transparenca e institucioneve vendore lufton korrupsionin, rrit besimin e qytetarëve si dhe forcon integritetin e udhëheqjes vendore. Monitorimi i transparencës vendore nga aktorët jopublikë ka një rëndësi të veçantë në nxitjen dhe promovimin e qytetarisë aktive në proceset vendimmarrëse. Transparenca e institucioneve vendore është parakusht i domosdoshëm për një qeverisje të hapur dhe demokratike. Nga ana tjetër, qeverisja e hapur është më e kontrollueshme nga qytetarët, pasi aksesi në informacionin publik u mundëson atyre të jenë të informuar për punën që bën qeveria. Qytetarët e informuar e kanë më të lehtë të monitorojnë qeverisjen vendore dhe të kërkojnë transparencë në interes të publikut.

## 7. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky studim ka filluar fillon me zhvillimin e një anketimi me qytetarët për të tërhequr opininin e tyre lidhur me nivelin e transparencës në Bashkinë Lezhë. Anketimi ka ofruar një mundësi krahasimore të transparencës së Bashkisë Lezhë, përmes monitorimit të Programit të Transparencës të publikuar në faqet e internetit, me mendimin e drejtpërdrejtë qytetar. Dmth sa ka reflektuar transparenca e shfaqur në faqen zyrtare të bashkisë tek qytetarët. Përmes këtij ballafasqimi, mund të realizohet një vlerësim objektiv i gjithë informacionit që publikohet në Programin e Transparencës, të grupuar në pesë fusha kryesore. Intervistat u zhvilluan drejtpërdrejt nga koordinatori, specialistët dhe grupet vullnetare të Qendrës IBRI. Në anketim u përfshinë fokusgrupe qytetarësh nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Lezhë. Në vijim grupi i ekspertëve ka realizuar analizën e të dhënave dhe ka nxjerrë rezultatet e anketimit, bazuar në opinionet e qytetarëve. Mbi bazën e këtyre rezultateve është hartuar raporti studimor i prodhuar në formën e Librit të Transparencës, me gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse.



## **8. FAZAT E STUDIMIT**

Studimi ka kaluar në këto faza:

### **8.1. Krijimi i hartës së kontakteve**

Krijimi i hartës së kontakteve me fokus-grupet e qytetarëve që anketohen, duke pasur parasysh gjininë, moshën dhe shpërndarjen e balancuar në njësitë administrative (Faza përgatitore).

### **8.2. Anketimi**

Anketimi në terren i fokusgrupeve lidhur me nivelin e transparencës në qeverisjen vendore.

### **8.3. Grumbullimi i të dhënave**

Grumbullimi i të dhënave, analiza dhe rezultatet e anketimit të realizuara nga grupi i ekspertëve.

### **8.4. Hartimi i raportit studimor**

Hartimi i raportit studimor me të gjitha gjetjet, shoqëruar me analizat, grafikat konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.

## 9. TË DHËNA PËR BASHKINË LEZHË

Bashkia Lezhë shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë. Bazuar në regjistrin e gjendjes civile, bashkia Lezhë, ka një popullsi prej rreth 106 245 banorë ndërsa sipas censusit të vitit 2011 ka 65 633 banorë dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 509 km<sup>2</sup>. Ajo përbëhet nga 10 njësi administrative: Lezhë, Shëngjin, Balldre, Blinisht, Dajç, Kallmet, Kolsh, Shënkoll, Ungrej dhe Zejmen. Mbi 40% e popullsisë jetojnë në dy qytetet Lezhë dhe Shëngjin. Lezha përbën një reliev të natyrës, ku mali, fusha, pylli, laguna dhe deti, përbëjnë një kombinim të rrallë. Bashkia e Lezhës shquhet për resurse të mëdha turistike. Në bashkinë Lezhë shtrihen disa nga plazhet bregdetare më të frekuentura të Shqipërisë si Plazhi i Shëngjinit, plazhi i Tales dhe Plazhi Rana e Hedhun. Në qytetin e Lezhës ndodhet varri i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu i cili frekuentohet nga shumë vizitorë vendas e të huaj. Po ashtu Kalaja e Lezhës përbën një nga resurset e rralla turistike të këtij qyteti.

Projekti “Ndërgjegjësimi dhe aktivizimi qytetar për rritjen e transparencës në bashkinë Lezhë” krijon instrumente bashkëpunimi që rrisin transparencën në vendimmarrjet e bashkisë dhe forcojnë kërkesën e llogarisë nga ana e qytetarëve. Ky projekt do të ndikojë në një pjesëmarrje më të gjerë dhe të balancuar qytetare në diskutimin e buxhetit, monitorimin e marrjes së vendimeve të Këshillit Bashkiak duke rritur kërkesën e publikut për transparencë. Projekti do të përmirësojë aksesin qytetar në informacionin publik të bashkisë Lezhë, në funksion të rritjes së transparencës me qëllim shmangien e abuzimeve dhe vendimmarrjeve korruptive.

Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për të monitoruar transparencën e institucionit të bashkisë nga njëra anë dhe rritja e kapaciteteve të zyrtarëve lokalë për ta institucionalizuar këtë transparencë nga ana tjetër, do të krijojë lidhjen ndërmjet projektit që po paraqesim dhe misionit të organizatës sonë për zhvillimin dhe integrimin e rajoneve të vendit, në kuadrin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim - SKZHI në Shqipëri.

## 10. FUSHAT E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

Qendra IBRI ka monitoruar 5 fusha të Programit të Transparencës.

1. Organizimi dhe funksionimi i bashkisë
2. Transparenca ekonomiko-financiare
3. Kërkesat për informim
4. Shërbimet e ofruara
5. Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje

Për secilën prej fushave është dhënë lista e dokumenteve si dhe kuadri rregullator përkatës. Secila fushë është ndarë në disa nënfusha në përmbajte të të cilave janë treguesit përkatës. Treguesit janë përzgjedhur duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, në përgjegjësitë, kompetencat, funksionet dhe procedurat përkatëse të Bashkisë Lezhë. Çdo tregues paraqet një dokument apo informacion që duhet të publikohet nga bashkia dhe të jetë i aksesueshëm për qytetarët. Treguesit masin nivelin e transparencës së bashkisë si dhe të shërbejnë për të vlerësuar gatishmërinë e zyrtarëve vendorë për të qenë të hapur ndaj qytetarëve dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrje. Niveli i realizimit të treguesit vlerësohet me përqindje (%), në bazë të sasisë dhe cilësisë së informacionit që rezulton nga monitorimi. Nëpërmjet mesatarizimit të treguesve nxirret rezultati i nënfushës dhe nëpërmjet mesatarisimit të rezultateve të nënfushave nxirret rezultati për fushën. Në fund nëpërmjet mesatares së nivelit të realizimit të fushave realizohet vlerësimi i nivelit të transparencës për Bashkinë Lezhë.

### **10.1. Nivelet e transparencës**

Nivelet e transparencës ndahen në 5 grupime:

1. Transparencë shumë e ulët.
2. Transparencë e ulët.
3. Transparencë mesatare.
4. Transparencë disi e lartë.
5. Transparencë shumë e lartë.

### **10.2. Nivelet e vlerësimit**

Vlerësimi realizohet me % dhe përkthehet në indeks zbatimi 1-5 sipas niveleve më poshtë.

- Niveli 1
- Niveli 2
- Niveli 3
- Niveli 4
- Niveli 5

#### **Niveli 1**

Ky nivel nënkupton faktin se, në realizimin e treguesve të transparencës, nuk ka pasur progres. Mungesa e progresit mund të ketë ardhur për arsye që lidhen me mungesën e legjislacionit, mosfunksionimin e administratës, ose mungesën e burimeve financiare.

Vlerësimi në përqindje, është 0-20%.

Rezultati në këtë vlerësim është “transparencë shumë e ulët”.

Rekomandohen masa të menjëhershme, për sigurimin e kushteve për plotësimin e Programit të Transparencës në përputhje me aktet dhe standardet rregullatore.

## **Niveli 2**

Ky nivel nënkupton faktin se, në realizimin e treguesve të transparencës, ka pasur pak progres. Progresi i ulët, mund të ketë ardhur për arsye që lidhen me mungesa të kuadrit rregullator të parashikuar, mosfunksionimin si duhet të administratës, apo pamjaftueshmërinë e burimeve.

Vlerësimi në përqindje është 21-40%.

Rezultati në këtë vlerësim është i “transparencë e ulët”.

Rekomandohen masa të shpejta, për plotësimin e kushteve ligjore dhe administrative për plotësimin e Programit të Transparencës në përputhje me aktet dhe standardet rregullatore.

## **Niveli 3**

Ky nivel nënkupton faktin se procesi i realizimit të treguesve të transparencës, është në progres e sipër dhe se objektivi rezulton i realizuar pjesërisht.

Vlerësimi në përqindje është 41-60%.

Rezultati në këtë vlerësim është “transparencë mesatare”.

Rekomandohet marrja e masave për plotësimin e kuadrit ligjor, vënien në zbatim të plotë të strukturave dhe mbështetje për plotësimin e Programit të Transparencës në përputhje me aktet dhe standardet rregullatore.

## **Niveli 4**

Ky nivel nënkupton faktin se, në realizimin e treguesve të transparencës, ka pasur progres të dukshëm në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe zbatimin e praktikave më të mira.

Vlerësimi në përqindje është 61-80%.

Rezultati në këtë vlerësim është “transparencë disi e lartë”.

Rekomandohet sigurimi i mbështetjes së plotë, për plotësimin tërësor dhe me cilësi të Programit të Transparencës në përputhje me aktet dhe standardet rregullatore.

## Niveli 5

Ky nivel nënkupton realizimin e plotë, ose pothuajse të plotë, të treguesve të transparencës në drejtim të zbatimit të legjislacionit, të ndërtimit të kapaciteteve institucionale, financimit dhe zbatimit të praktikave më të mira.

Vlerësimi në përqindje është 81-100%.

Rezultati në këtë vlerësim është “transparencë shumë e lartë”.

### Tabela e vlerësimit

Nr.	Niveli 1-5	Niveli në %	Kategoria e performancës
1	Niveli 1	0 -20%	Transparencë shumë e ulët
2	Niveli 2	21- 40%	Transparencë e ulët
3	Niveli 3	41- 60%	Transparencë mesatare
4	Niveli 4	61- 80%	Transparencë disi e lartë
5	Niveli 5	81-100%	Transparencë shumë e lartë

### 10.3. Kronologjia e vlerësimit

- Fusha
- Nënfisha
- Treguesit

Vlerësimi i nivelit të transparencës së Bashkisë Lezhë është realizuar në mënyrë të përshkallëzuar, nga poshtë lart, duke filluar me nivelin e realizimit të treguesve, që përcaktojnë nivelin e realizimit të nënfushave e fushave dhe duke përfunduar me vlerësimin e nivelit të transparencës së bashkisë.

Për vlerësimin e nivelit të transparencës, ndiqet kronologjia e mëposhtme:

1. Treguesi
2. Nënfisha
3. Fusha
4. Niveli i transparencës së bashkisë



## Përshkrimi i mënyrës së vlerësimit

- Niveli i realizimit të treguesve për çdo nënfushë, shprehet në përqindje dhe përkthehet në indeks zbatimi 0-5.
- Nëpërmjet mesatares së indekseve të zbatimit të treguesve, vlerësohet niveli i realizimit të nënfushës.
- Nëpërmjet mesatares së indekseve të zbatimit, për nivelin e realizimit të nënfushave, vlerësohet niveli i realizimit të fushës.
- Nëpërmjet mesatares së realizimit të fushave, shprehur me indeks zbatimi, vlerësohet niveli i transparencës së Bashkisë Lezhë.





# 11. VLERËSIMI TRANSPARENCËS NË BASHKINË LEZHË

## FUSHA I “ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BASHKISË”

### Nënfushat

#### 1. Kuadri rregullator

(Treguesit: Aktet ligjore dhe nënligjore. Legjislacioni mbi dokumentet politike kombëtare përkatëse. Legjislacioni mbi vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit bashkiak me karakter normativ. Legjislacioni mbi vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ. Legjislacioni mbi dokumentet politike vendore.

NENFUSHA	TREGUESI	%	Niveli 1- 5
1.Kuadri rregullator	1.Aktet ligjore dhe nënligjore	100%	
	2.Legjislacioni mbi dokumentet politike kombëtare përkatëse	100%	
	3.Legjislacioni mbi vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit bashkiak me karakter normativ	100%	
	4.Legjislacioni mbi vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ	100%	
	5.Legjislacioni mbi dokumentet politike vendore	100%	
	<b>VLERËSIMI</b>	<b>100%</b>	<b>5</b>

#### 2. Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet

(Treguesit: Ndarja administrativo-territoriale e bashkisë. Detyrat, përgjegjësitë dhe funksionet e bashkisë).

NENFUSHA	TREGUESI	%	Niveli 1- 5
2.Organizimi administrativo-territorial, misioni e funksionet	1.Ndarja administrativo-territoriale e bashkisë	100%	
	2.Detyrat, përgjegjësitë dhe funksionet e bashkisë	100%	
	<b>VLERËSIMI</b>	<b>100%</b>	<b>5</b>

### 3. Organet e bashkisë

